



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 2 Qershor 2021

Nr. 384

**VENDIM**

**Objekt:** Për shqyrtimin administrativ të denoncimit për shkelje të parashikuar në nenin 79 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, ndaj kryetarit të bashkisë Gjirokastrë dhe bashkisë Durrës.

**Kërkues:** Institucioni i Presidentit të Republikës së Shqipërisë

**Ndaj:** kryetarit të bashkisë Gjirokastrë dhe bashkisë Durrës

**Baza ligjore:** Nenet 19, pika 1, shkronja “dh”, “f” dhe ‘n”, pika 2, dhe 79, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nenet 60, 61 dhe vijues të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, udhëzimi nr. 6, datë 23.3.2021 “Për përdorimin e materialeve propagandistike edukuese dhe rregullat për afishimin e tyre gjatë fushatës zgjedhore” të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur nga administrata gjatë procesit të hetimit administrativ,

**VËREJ:**

**I. Vlerësimi paraprak**

Në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve është administruar një denoncim me nr. 4017 prot., datë 20.04.2021, nga Institucioni i Presidentit të Republikës së Shqipërisë për shkelje të nenit 79 të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar dhe



udhëzimit nr. 6, datë 23.3.2021 “Për përdorimin e materialeve propagandistike edukuese dhe rregullat për afishimin e tyre gjatë fushatës zgjedhore” të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve.

Sipas denoncimit të datës 20.04.2021, nr. 4017 prot., pretendohet se: “Vendosja e materialeve propagandistike, postera dhe foto të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, SH.T.Z Ilir Meta, të ish –Kryeministrit dhe ish-Presidentit zotit Sali Berisha, si dhe drejtuesit e opozitës, kryetarit të Partisë Demokratike, zotit Lulzim Basha, kryetares së Lëvizja Socialiste për Integrim, zonjës Monika Kryemadhi, jo vetëm janë manipuluar me përmbajtje aspak etike dhe morale por edhe janë shoqëruar poshtë me dixhiturën “KËTA NUK MERITOJNË MË ASNJË SHANS”.

Sipas fotove bashkëlidhur, tabelat ku janë vendosur materialet me përmbajtje të qartë propagandistike dhe fyese, vendi ku janë instaluar hyn në kompetencën administrative territoriale dhe përgjegjësinë dhe administrimin e bashkisë Gjirokastrë dhe bashkisë Durrës që në këto raste kanë lejuar vendosjen e këtyre materialeve në:

- Fyerje të figurës së Kreut të Shtetit;
- Shkelje flagrante të çdo norme etike;
- Shkelje flagrante të nenit 79 pika 3 të Kodit Zgjedhor, pasi ky poster për vetë përmbajtjen që ka dhe me qëllim shmangien e përgjegjësisë, nuk përmban shënimin detyrues që sanksionon Kodi Zgjedhor: “Prodhuar nën përgjegjësinë ligjore të...” (vijon emri i subjektit zgjedhor).”

Sipas përcaktimeve të nenit 19, pika 1, shkronja “dh”, “f” dhe “n”, pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ka kompetencat si më poshtë:

- dh) kujdeset për zbatimin e këtij ligji në mënyrë të drejtë, të përpiktë, të saktë dhe uniforme nga të gjitha institucionet, subjektet apo personat e ngarkuar me detyra dhe detyrime, sipas ligjit;
- f) monitoron nëpërmjet administratës së KQZ-së apo subjekteve të kontraktuara sjelljen e institucioneve publike gjatë fushatës dhe përdorimin e burimeve publike;
- n) ushtron në emër të KQZ-së kompetencat që i ngarkohen asaj me ligje të veçanta, si dhe çdo kompetencë që ky ligj nuk i’a njeh shprehimisht Rregullatorit apo Kas-it.

Sipas përcaktimeve të nenit 23, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve shqyrtoi paraprakisht kërkesat lidhur me kompetencën e organit publik për shqyrtimin e tij.

Referuar nenit 82 e vijues të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, KQZ çmon se të dhënat e paraqitura nga subjekti kallëzues Institucioni i Presidentit të



Republikës së Shqipërisë, përbëjnë indicie të besueshme për të filluar një procedurë administrative.

## II. Rrethanat e faktit

Me shkresën nr. 3903 prot., datë 18.04.2021, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ka marrë masa të menjëhershme duke i kërkuar subjektit politik Partisë Socialiste të Shqipërisë që në respektim të rregullave dhe parimeve për zhvillimin e një fushatë zgjedhore sipas standardeve dhe të praktikave të mira në fushën e zgjedhjeve të merrte masa të menjëhershme për heqjen e materialeve propagandistike.

Me shkresën nr. 4011 prot., datë 20.04.2021, subjekti politik Lëvizja Socialiste për Integrim ka depozituar ankesën me lëndë “Vendosje e materialeve diskriminuese në hapësira publike”, pasi në datë 17.04.2021 në të gjitha billboard-et e lagjes “18 shtatori”, në Gjirokastër janë vendosur materiale vizive diskriminuese për persona publikë.

Me shkresën nr. 4440 prot., datë 24.04.2021, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve i ka kërkuar kryetarit të bashkisë Gjirokastër marrjen e masave të menjëhershme për heqjen e materialeve propagandistike, nga billboard-i i lagjes “18 shtatori”, në bashkinë Gjirokastër.

Me shkresën nr. 4008 prot., datë 20.04.2021, subjekti politik Partia Demokratike ka depozituar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve kërkesën me lëndë për konstatimin e veprimeve të paligjshme të bashkisë Durrës dhe reagimin e menjëhershëm të Policisë së Shtetit.

Me shkresën nr. 4196 prot., datë 22.04.2021 bashkia Durrës, në përgjigje të shkresës së sipërcituar të subjekti politik Partia Demokratike ka sqaruar se: “Vendosja e posterave në godinat publike përkatësisht në ambientet e Pallatit të Sportit, nuk është miratuar nga bashkia Durrës. Bashkia Durrës në momentin që ka konstatuar vendosjen e këtyre posterave ka njoftuar në mënyrë të menjëhershme Policinë Bashkiake nëpërmjet shkresës nr. 4997 prot., datë 19.04.2021, duke i kërkuar kësaj të fundit respektimin e udhëzimit nr. 6/2021 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve. Në vijim të këtij njoftimi është proceduar me marrjen e masave duke bërë të mundur heqjen e këtyre posterave nga godina ku ishin vendosur.

## III. Analiza ligjore

Referuar nenit 2, pika 31, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, “... *materiale propaganduese statike janë materialet që i shërbejnë subjektit zgjedhor për promovimin e fushatës zgjedhore dhe që janë vendosur ose afishuar në vende ose hapësira*



publike me akses publik, si shtyllat e ndriçimit të rrugëve, fasadat e ndërtesave, sheshet, pjesët balllore të dyqaneve ose ndërtesave, përgjatë rrugëve të qyteteve, rrugëve ndërqytetëse etj.

Referuar neni 78, pika 1, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, “...gjatë fushatës zgjedhore çdo subjekt zgjedhor ka të drejtë të bëjë propagandë zgjedhore në çdo mënyrë të ligjshme”.

Referuar nenit 79, të ligjit nr. 10 019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, parashikohet se:

- “Jo më vonë se 35 ditë para datës së zgjedhjeve, kryetari i bashkisë, në mënyrë të drejtë dhe të paanshme, përcakton vendet publike në territorin e bashkisë përkatëse për afishimin prej partive politike dhe subjekteve zgjedhore të materialeve propagandistike. Vendet e caktuara duhet të jenë në ambiente që sigurojnë shikueshmëri publike dhe të kenë hapësirë të mjaftueshme ku të gjitha subjektet zgjedhore që marrin pjesë në zgjedhje të paraqesin programet e tyre zgjedhore dhe mesazhet zgjedhore. Vendimi i kryetarit të bashkisë bëhet publik në faqen e internetit të bashkisë menjëherë pas miratimit”.
- “Të gjitha materialet propagandistike vizive që përdoren në fushatë duhet të shoqërohen me shënimin: “Prodhuar nën përgjegjësinë ligjore të...” (vijon emri i subjektit zgjedhor)”.
- Policia Bashkiake dhe/ose Policia e Shtetit garantojnë zbatimin e përcaktimeve të bëra në këtë nen duke hequr menjëherë çdo material propagandues të subjekteve zgjedhore në vendet jashtë përcaktimeve të bëra në pikat 1 dhe 2 të këtij neni.

Referuar udhëzimit nr. 6, datë 23.03.2021 “Për përdorimin e materialeve propagandistike edukuese dhe rregullat për afishimin e tyre gjatë fushatës zgjedhore” në nenin 3, të tij parashikohet se:...”Kryetarët e bashkive duhet të marrin masa për të mos lejuar apo të heqin menjëherë çdo material statik, përfshirë posterat dhe flamujt nga çdo vendndodhje tjetër ku ato konstatohen që nuk janë vendosur në përputhje me kriteret e këtij udhëzimi”.

Referuar denoncimit të mësipërm dhe në mbështetje të dokumentacionit të disponuar, provave dhe fakteve të administruara, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ka mbajtur një qëndrim për çdo rast të trajtuar në këtë denoncim, duke marrë masat e menjëhershme për heqjen e materialeve propagandistike, të cilat ishin vendosur në kundërshtim me dispozitat e ligjit nr. 10 019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar dhe udhëzimit nr. 6, datë 23.3.2021, “Për përdorimin e materialeve propagandistike edukuese dhe rregullat për afishimin e tyre gjatë fushatës zgjedhore”.



Referuar korrespondencës shkresore ndërmjet Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve dhe bashkive Gjirokastër dhe Durrës, kryetarët e bashkive përkatëse kanë marrë masat duke ngarkuar policinë bashkiake për heqjen e materialeve propagandistike që ishin vendosur në kundërshtim me dispozitat e ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar dhe udhëzimit nr. 6, datë 23.3.2021, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve.

### **PËR KËTO ARSYE:**

Bazuar në nenin 19, pika 1, shkronja “dh”, “f”, “n”, pika 2, 79 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nenit 60 dhe vijues të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, udhëzimi nr. 6, datë 23.3.2021 “Për përdorimin e materialeve propagandistike edukuese dhe rregullat për afishimin e tyre gjatë fushatës zgjedhore” të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve:

### **V E N D O S:**

1. Përfundimin e shqyrtimit administrativ të kallëzimit ndaj kryetarit të bashkisë Gjirokastër dhe bashkisë Durrës.
2. Rezultatet e këtij vendimi i njoftohen me postë elektronike denoncuesit.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve, brenda 3 (tre) ditëve nga hyrja e tij në fuqi.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

**Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**

**Ilirjan CELIBASHI**

